

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës së Prizrenit për fillimin e negociatave me PTK-në për avancimin e sistemit të komunikimit për telefonat mobil dhe fiks, kryetari i Komunës, më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës së Prizrenit rreth lejimit të fillimit të negociatave me Postën dhe Telekomin e Kosovës lidhur me avancimin e sistemit të komunikimit për telefonat mobil dhe telefonat fiks.

Neni 2.

Autorizohet nënkryetari Komunës së Prizrenit, Ruzhdi Rexha, që në emër të Komunës së Prizrenit mund të fillojë negociatat me zyrtarët kompetentë të Postës dhe Telekomit të Kosovës për avancimin e sistemit të komunikimit për telefonat mobil dhe telefonat fiks të Komunës së Prizrenit.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: nënkryetari i Komunës së Prizrenit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës së Prizrenit, drejtorët e drejtorive, PTK, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e Zyrës së Gjendjes Civile, në lagjen “Dardania”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të ndërtimit të Zyrës së Gjendjes Civile në ngastrën kadastrorë nr. 1948/10, pronë komunale, në lagjen “Dardania”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtorja e Administratës dhe Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtorja e Administratës, Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me qira të ndërtesës së ish Arkivit Regjional - Shoqatës së të burgosurve politikë dhe Shoqatës së familjeve të dëshmorëve, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me qira të ndërtesës së ish Arkivit Regjional - Shoqatës së të burgosurve politikë dhe Shoqatës së familjeve të dëshmorëve.

II. Shoqatës së të burgosurve politikë i jepen në shfrytëzim dy zyra nga kjo ndërtesë me qira prej 1 € në muaj.

III. Shoqatës së familjeve të dëshmorëve i jepen në shfrytëzim dy zyra të tjera nga kjo ndërtesë me qira prej 1 € në muaj.

IV. Shoqata e invalidëve të luftës do të kalojë në zyrat e Organizatës së veteranëve të luftës.

V. Zyrat e mëparshme, pronë komunale, do t'i dorëzohen nga ana e shoqatave-organit kompetent komunal, Sektorit për Çështje Pronësore dhe Juridike,

VI. Obligohet Drejtoria e Administratës - Sektori i Pronës që të përpilojë kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të zyrave - shoqatave të lartcekura.

VII. Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, i datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, shoqatat e lartcekura, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës- Zyra për Çështje Gjinore, të datës 26.3.2012, për miratimin e Planit të Veprimit për barazi gjinore të Komunës së Prizrenit për periudhën 2012-2014, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

U shqyrtua propozimi i Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, i datës 26.3.2012, për miratimin e Planit të Veprimit për barazi gjinore të Komunës së Prizrenit për periudhën 2012-2014. Ky plan është financuar nga Caritasi zviceran dhe është hartuar nga OJQ “Dora-Dorës”, dhe në bashkëpunim me Zyrën për barazi gjinore të Komunës së Prizrenit.

Plani i veprimit për barazi gjinore të Komunës së Prizrenit për periudhën 2012-2014 do t’i procedohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria e Administratës- Zyra për Çështje Gjinore që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës- Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, KPF, Kuvendi i Komunës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, për mbështetje financiare të OJQ “Down Syndrome Kosova”, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, bazuar në kërkesën e OJQ “Down Syndrome Kosova”, dega në Prizren, për mbështetje financiare me qëllim të realizimit të projektit të quajtur “Hipo-terapi”. Ky projekt do të realizohet gjatë muajit prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe tetor 2012 në kampin “Vali Ranch” në Gjilan. Ndërkaq, Kuvendi i Komunës së Prizrenit mbulon shpenzimet e kalërimit në shumën prej 1120 €, si dhe do të bëjë transportin e pjesëmarrësve nga Prizreni në kampin e lartcekur dhe anasjelltas me autobusin e Komunës.

Neni 2

Transportimi i pjesëmarrësve nga Prizreni në kampin e lartcekur dhe anasjelltas me autobusin e Komunës për periudhën e theksuar, i cili transport është llogaritur në shumën prej 1750 €, Kuvendi i Komunës së Prizrenit e llogarit këtë si donacion dhe mbështetje financiare për OJQ “Down Syndrome Kosova”, dega në Prizren.

Neni 3

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Administratës dhe drejtorive të tjera.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës- Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 72/2012, të datës 26.3.2012 rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës “Tamil Shala 1”, me elemente të betonit dhe me participim, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 72/2012, i datës 26.3.2012 rreth lejitimit të ndërtimit të rrugës “Tamil Shala 1”, me elemente të betonit dhe me participim, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për realizimin e këtij projekti, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, i datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 70/2012, të datës 26.3.2012 rreth lejimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës “Ylber Fanaj” në lagjen “Bajram Curri”, me elemente të betonit dhe me participim, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 70/2012, i datës 26.3.2012 rreth lejimit të ndërtimit të rrugës “Ylber Fanaj” në lagjen “Bajram Curri”, me elemente të betonit dhe me participim, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për realizimin e këtij projekti, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 73/2012, të datës 26.3.2012 rreth lejimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugëve lokale dhe kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Jeshkovë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 73/2012, i datës 26.3.2012 rreth lejimit të ndërtimit të rrugëve lokale dhe kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Jeshkovë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 74/2012, të datës 26.3.2012 rreth lejimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugëve lokale, kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujësjellësit në fshatin Lubizhdë e Prizrenit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 74/2012, i datës 26.3.2012 rreth lejimit të ndërtimit të rrugëve lokale, kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujësjellësit në fshatin Lubizhdë e Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 75/2012, të datës 26.3.2012 rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve sipas praktikës së participimit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike nr. 75/2012, i datës 26.3.2012, rreth lejitimit të ndërtimit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve sipas praktikës së participimit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës “Rrustë Kabashi”,
2. Rrugës “Rrustë Kabashi-1”
3. Rrugës “Lui Paster” dhe
4. Kanalizimin në rrugën “Nëna Mbretëreshë”

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, i datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 26.3.2012, rreth lejimit të udhëtimit zyrtar për në Japoni dhe pagesës së mëditjeve për Ramadan Tafallarin dhe Galip Belallarin – zyrtarë të shërbimit civil të Komunës, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 26.3.2012, për lejimin e udhëtimit zyrtar dhe pagesën e mëditjeve për Ramadan Tafallarin dhe Galip Belallarin – zyrtarë të shërbimit civil të Komunës, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që organizohet nga Organizata JICA, që ka të bëjë me projektin “Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave”. Trajnimi do të mbahet nga data 14 maj deri me 27 maj 2012 në Japoni, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, i datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, të lartcekurit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për realizimin e edicionit të 11-të të Festivalit të filmit dokumentar dhe të shkurtër “DOKUFEST 2012”, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 28.3.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për realizimin e edicionit të 11-të të festivalit të filmit dokumentar dhe të shkurtër “DOKUFEST 2012”, që mbahet nga data 7-15 korrik 2012 në Prizren, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 15.000 €.

Çdo shërbim tjetër i ofruar nga ana e Komunës së Prizrenit lidhur me realizimin e festivalit të lartcekur, Kuvendi i Komunës së Prizrenit e llogarit si mbështetje financiare dhe e konsideron si donacion për këtë qëllim.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për Festivalin folklorik “Hasi Jehon-2012”, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

a. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 28.3.2012, bazuar në kërkesën e ShKA “Malësori” rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për Festivalin folklorik “Hasi Jehon-2012”, i cili do të mbahet në fshatin Gjonaj, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 5000 €.

b. Obligohet organizatori i festivalit që në prezantimet e sponsorëve nëpër sheshe dhe vende të ndryshme të vëhet edhe logoja e Komunës së Prizrenit.

c. Dhënie në shfrytëzim të objektit të Shtëpisë së Kulturës në fshatin Gjonaj për organizimin dhe mbajtjen e festivalit “Hasi Jehon 2012”, Kuvendi i Komunës së Prizrenit e llogarit si mbështetje financiare dhe e konsideron si donacion për këtë qëllim.

d. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, i datës 24.1.2012.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare të ShKA “Agimi”, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 28.3.2012, rreth mbështetje financiare të ShKA “Agimi”, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tyre kulturore dhe artistike për tërë vitin 2012, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 3000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare për Teatrin Profesionist të Prizrenit, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare për Teatrin Profesionist të Prizrenit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve lidhur me realizimin e projektit “Monserati”, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 15.000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare për Shoqatën e aktorëve të teatrit Turk-“Rumeli”, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare për Shoqatën e aktorëve të teatrit Turk-“Rumeli”, me qëllim të realizimit të pjesës teatrale të quajtur “39 shkallë”, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare për organizimin e Turneut në futboll që mbahet në Prizren, i cili i kushtohet dëshmorit Pal Paluca, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 27.3.2012, rreth mbështetjes financiare me qëllim të organizimit të turneut në futboll që mbahet në Prizren, e që fillon më 5 maj 2012, i cili turne i kushtohet dëshmorit të kombit Pal Paluca, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 28.3.2012, rreth mbështetjes financiare me qëllim të organizimit të turneut tradicional në futboll të vogël për veteranët e futbollit nga Prizreni, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 27.3.2012, rreth mbështetjes financiare me qëllim të organizimit të turneut tradicional në futboll të vogël për veteranët e futbollit nga Prizreni, i cili turne do të mbahet në periudhën prill-maj 2012 në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-3288

Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rreth lejimit të shpalljes së tenderit për shitjen e masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rreth lejimit tenderimit të masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore gjatë vitit 2011, kështu që lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e 58 m³ dru dhe atë sipas specifikacionit të prezantuar.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-3288

Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me karrige stomatologjike për nevojat e QKMF, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të furnizimit me karrige stomatologjike për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për furnizim me 3 karrige stomatologjike.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me pajisje laboratorike për nevojat e QKMF-së dhe QMF-1, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të furnizimit me pajisje laboratorike për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Qendrës së Mjekësisë Familjare -1, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me pjesë elektronike për kompjuterë për nevojat e QKMF-së dhe QMF-ve dhe AMF-ve, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të furnizimit me pjesë elektronike për kompjuterë për nevojat e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-3288

Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me inventar të nevojshëm për nevojat e QKMF-së dhe QMF-ve dhe AMF-ve, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të furnizimit me inventar të nevojshëm për nevojat e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve dhe objektet e tjera shëndetësore që do të ndërtohen këtë vit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me pajisje stomatologjike për nevojat institucioneve shëndetësore, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë rreth lejimit të furnizimit me pajisje stomatologjike për nevojat institucioneve shëndetësore, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 28.3.2012, rreth lejitimit të shpalljes së konkursit për ndarjen e bursave për vitin kalendarik 2012, për studentët të cilët studiojnë në universitetet publike të Republikës së Kosovës dhe për nxënës të familjeve të dëshmorëve të UÇK-së të shkollave të mesme dhe fillore, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

a. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 28.3.2012, dhe lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për vitin kalendarik 2012, për studentët të cilët studiojnë në universitetet publike të Republikës së Kosovës dhe për nxënës të familjeve të dëshmorëve të UÇK-së të shkollave të mesme dhe fillore.

b. Për studentë lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e 80 bursave dhe 40 bursa për nxënës të familjeve të dëshmorëve të UÇK-së, të cilët i vijojnë mësimet në shkollat e mesme dhe fillore.

c. Për këtë qëllim, nga buxheti i arsimit – pozicioni i subvencioneve lejohen mjetet e nevojshme në lartësi prej 50.000 € (40.000€ për bursa të studentëve dhe 10.000 € për nxënësit e familjeve të dëshmorëve të UÇK-së)

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës, komisioni përkatës dhe Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës rreth lejimit të shpalljes së tenderit për renovimin e dysHEMEVE të dhomave të mësimit në ShFMU “Meto Bajraktari” në Reqan, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës rreth lejimit të renovimit të dysHEMEVE të dhomave të mësimit në Shkollën Filllore të Mesme dhe të Ultë “Meto Bajraktari” në Reqan, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-3288

Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e rrethojës së ShFMU “Dëshmorët e Zhurit” në Zhur, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës rreth lejimit të rregullimit të rrethojës së Shkollën Fillore të Mesme dhe të Ultë “Dëshmorët e Zhurit” në Zhur, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e rrethojës dhe terrenit sportiv së ShFMU “Pllanjane” në fshatin në Pllanjan, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës rreth lejimit të rregullimit të rrethojës së shkollës dhe terrenit sportiv në Shkollën Filllore të Mesme dhe të Ultë “Pllanjane” në fshatin në Pllanjan, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, të datës 27.3. 2012, rreth lejimit të mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Abdylah Gjini menaxherin e tatimit në pronë në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, i datës 27.3. 2012, rreth lejimit të mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Abdullah Gjinin, menaxher i tatimit në pronë në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 2000 €. Mjetet lejohen pas parashtrimit të faturave.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 28.3.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për Shoqatën e Grave Turke “Zubeyde Hanim” nga Prizreni, për pagesë të shpenzimeve të ushqimit për nder të 8 Marsit-Ditës së Gruas, kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 28.3.2012, për lejimin e mjeteve financiare për Shoqatën e Grave Turke “Zubeyde Hanim” nga Prizreni, për pagesë të shpenzimeve të ushqimit për nder të 8 Marsit-Ditës së Gruas, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së shpenzimeve të ushqimit, lejohen mjetet në shumën 600 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Shoqata, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 28.3.2012, rreth lejimit të mjeteve për furnizim me material ndërtimor për tri familje, të evidentuara si raste sociale (2 boshnjakë dhe 1 ashkali), kryetari i Komunës më 3 prill 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 28.3.2012, rreth lejimit të mjeteve për furnizim me material ndërtimor për tri familje, të evidentuara si raste sociale (2 boshnjakë dhe 1 ashkali), dhe atë për:

- a. Ajvaz Imeri, pjesëtar i komunitetit boshnjak lejohen mjete në shumën prej 2252 € në emër të sigurimit të materialit ndërtimor për ndërtimin e kulmit të shtëpisë;
- b. Skender Gashi, pjesëtar i komunitetit ashkali, i lejohen mjetet në shumën prej 2582.30 € në emër të sigurimit të materialit ndërtimor për kulm, dhe
- c. Sejdia Rexha, pjesëtar i komunitetit boshnjak, i lejohen mjetet në shumën prej 2940.80 €, në emër të sigurimit të materialit ndërtimor për ndërtim të shtëpisë.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtorja e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Shoqata, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-3288
Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës-Sektorit për Çështje Pronësore dhe Juridike, të datës 2.4.2012 rreth lejitimit të inicimit të procedurave ligjore për shpalljen e interesit publik për pronën e paluajtshme në ngastrën kadastrore nr. 2368, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Sektorit për Çështje Pronësore dhe Juridike, i datës 2.4.2012, rreth lejitimit të inicimit të procedurave ligjore për shpalljen e interesit publik për pronën e paluajtshme në ngastrën kadastrore nr. 2368, në vendin e quajtur ish “Dubrava” tani “Remzi Ademaj”, me qëllim, që e njëjta pronë të shfrytëzohet për nevojat e administratës së Komunës së Prizrenit.

Ky propozim t’i procedohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, për shqyrtim dhe vendimarrje

Obligohet Drejtoria e Administratës-Sektorit për Çështje Pronësore dhe Juridike dhe Zyra Ligjore që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa, Komisionin e Pronës dhe në Kuvendin e Komunës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës-Sektorit për Çështje Pronësore dhe Juridike dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës-Sektorit për Çështje Pronësore dhe Juridike, Zyra Ligjore, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-3288

Më 3.4.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.4.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor rreth lejimit të shpalljes së tenderit për vendosjen dhe montimin e shtyllës në të cilën do të vendoset flamuri i Republikës së Kosovës në Kala, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor rreth lejimit të vendosjes dhe montimit të shtyllës në të cilën do të vendoset flamuri i Republikës së Kosovës në Kala, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Pjesë përbërëse e këtij Konkluzioni është edhe vendimi i kryetarit të Komunës nr. 01/06-821, të datës 24.1.2012.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja